

EKSPLOKIM I MODELIT TË PORTOFOLIT TË REZILIENCËS PAS PËRJETIMIT TË
VIKTIMIZIMIT

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË DREJTIMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

NJOMZA ADEMI

EKSPOZE E PUNIMIT TË TEMËS SË MASTERIT



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

PRISHTINË

Nëntor, 2022

Eksplorimi i modelit të portofolit të reziliencës pas përjetimit të viktimizimit

Kandidati: Njomza Ademi

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Kaltrina Kelmendi

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë ndikimin e modelit të portofolit të reziliencës tek individët pas ngjarjeve të rëndësishme në jetë, të kuptojë mekanizmat e mbështetjes dhe ballafaqimit që përdorin ata kur kalojnë kohëra të vështira në jetën e tyre, kuptimin e përvojave ndaj këtyre ngjarjeve, menaxhimin e tyre, rolin e familjes shoqërisë dhe komunitetit kur ballafaqohen me to, në mënyrë që ta kenë më të lehtë tejkalimin e këtyre situatave.

Punimi është strukturuar në tre kapituj

Kpitulli i I – Ky kapitull përmban hyrjen, arsyen qëllimin e këtij punimi, si dhe ndikimin që kanë përdorimi i pikave të forta te njerëzit në zhvillimin e reziliencës pas ngjarjeve traumatike. Gjithashtu në kapitull shqyrtohet edhe literatura e cila është bazuar në libra dhe artikuj shkencor të cilët studiojnë modelin e portofolit të reziliencës, dhe rëndësinë e faktorëve mbrojtës në zhvillimin e saj. Literatura na ofron teorinë e modelit të portofolit të reziliencës, dhe mënyrat e zhvillimit të saj për një përshtatje pozitive.

Pyetjet e këtij studimi janë:

- a) Të kuptohet ndikimi i i pikave të forta ndaj ngjarjeve të vështira.
- b) Të kuptuarit e mekanizmave mbështetës me të cilat përballen individët në ngjarje të rëndësishme signifikante në jetën e tyre.

Kapitulli i II - Në këtë kapitull është paraqitur metodologjia e përdorur, pjesëmarrësit në studim dhe intervista. Intervista gjysëm e strukturuar përbëhet nga 12 pyetje të hapura të ndara në 3 pjesë. Pas realizimit të intervistës u bë përzgjedhja dhe transkriptimi i gjithë informacionit të marrë. Janë kryer gjithësej gjashtë (6) intervista individuale. Ato u realizuan në qytetin e Prishtinës.

Kapitulli i III – Në këtë kapitull janë paraqitur analiza e të dhënave të punimit dhe rezultatet. Realizimi i intervistës ka marrë kohë, sepse përgjigjet e tyre janë shkruar aty për aty, dhe ndërprerja gjatë rrëfimit të ngjarjeve në mënyrë që të shkuheshin përgjigjet, mund të ketë ndarë pjesë jo më pak të rëndësishme nga rrëfimet e tyre.

Rezultatet tregojnë se përdorimi i pikave të forta, si mekanizma mbrojtës të njeriut ndikojnë pozitivisht në zhillimin e reziliencës. Ndikimi i këtyre pikave të forta, lehtëson përballimin ndihmon rimëkëmbjen dhe mundëson vazhdimin përpara pas përvojave traumatike e të vështira në jetë.